



Prishtinë, 10 shkurt 2017

NJOFTIM

Është mbajtur mbledhja e II e Bordit të ZRRE-së për vitin 2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në takimin e tij të dytin me radhë për këtë vit, të mbajtur me 9 shkurt 2017, ka vendosur për lëshimin e Autorizimeve finale për ndërtim të kapaciteteve të reja të energjisë nga Burimet e Renouveshme (BRE) me kapacitet prej 3.9 MW, të shoqërisë “EUROKOS JH” sh.p.k në komunën e Dragashit.

Gjithashtu Bordi pas shqyrtimit të kërkesave të kompanisë “ÇETA – GENERAL INVEST GROUP” sh.p.k; dhe “AFA ENERGY” sh.p.k, dhe duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, ka shtyrë afatet për vlefshmërinë e Autorizimeve Preliminare për ndërtim të kapaciteteve të reja të energjisë nga BRE për periudhën 6 mujore, ashtu siç përcaktohet në rregullën e Autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja të energjisë.

Bordi ka shqyrtuar edhe disa ankesa të konsumatorëve duke përfshirë edhe apelime të Operatorit të Furnizimit KESCO ndaj vendimeve të ZRRE, si dhe ka diskutuar për gjendjen e sektorit të energjisë në vend.

Të gjitha vendimet e Bordit do të publikohen në faqen elektronike të ZRRE www.ero-ks.org